



**FONDI SHQIPTAR  
I ZHVILLIMIT**

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“AGJENCIA E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE” SH.P.K.**

Ky akt themelimi, u përpilua më datë 31/08/2022, nga ortaku themelues.

**Fondit Shqiptar të Zhvillimit**, një person juridik shqiptar me zotësi të plotë juridike, me NIPT:J62325010W, dhe adresë Rr."Muhamet Gjollështa", Nd 70/1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Z. Dritan Agolli**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.09.1970 lindur në Fier dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. H00914093K,

i cili, me nënshkrimin e këtij akti dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, ligjin nr. 10130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit bashkëlidhur, si pjesë integrale dhe thelbësore e këtij Akti Themelimi.

**Neni 1  
Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë**

1. Shoqëria emërtohet **“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve” Sh.p.k** dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, (këtu e më poshtë **“Shoqëria”**).
2. Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2  
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën Rr."Muhamet Gjollështa", Nd 70/1, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë që me vendim të Asamblesë së Ortakëve të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

### Neni 3 Identiteti i Themeluesit

Ortaku themelues i Shoqërisë është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, person juridik shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, krijuar në bazë të ligjit Nr.10130, datë 11.5.2009 dhe me adresë Rr."Muhamet Gjollështa", Nd 70/1, Tiranë, Shqipëri.

### Neni 4 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin aktivitetet e mëposhtme:

1. Vënia në efikasitet e pasurive publike të degraduara apo me potencial të pazhvilluar në funksion të zhvillimit rajonal duke angazhuar kapitalin e FSHZH-së, kapitalin publik dhe/ose kapitalin privat.
2. Kryerjen e investimeve dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike duke angazhuar kapital publik dhe/ose privat vendas dhe/ose të huaj.
3. Projektimin, ndërtimin, rikonstruksion, restaurim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me tipologjitë e ndryshme të ndërtësive me karakter social, kulturor, tregtar, publik etj.
4. Ofrimin e shërbimeve, mallrave, punimeve dhe aktiviteteve të tjera në funksion të projektimit, ndërtimit, zhvillimit, regjistrimit të pasurive, vënies në shfrytëzim të pasurive të paluajtshme, administrimit, mirëmbajtjes, energjisë së rinovueshme, zhvillimit të komunitetit etj.
5. Të operojë si shoqëri administruese për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa, ambiente të përbashkëta si zona gjelbërimi, fusha sportive, parking etj në marrëveshje me pushtetin vendor dhe/ose aktorë të tjerë.
6. Kërkime, analizë, studime, planifikime, projekte, konsulencë dhe çdo lloj shërbimi tjetër në fushën e pasurive të paluajtshme duke përfshirë sektorin publik dhe privat; identifikimin e objekteve apo zonave me potencial zhvillimi ekonomik në nivel rajonal apo kombëtar; aplikimin e trendeve të teknologjisë në funksion të zhvillimit, menaxhimit dhe administrimit të aseteve.
7. Shoqëria mund të realizojë çdo lloj aktiviteti, operacion financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi; financimin ose bashkëfinancimin e projekteve nëpërmjet instrumentave ekonomike për realizimin e objektivave të përcaktuara në statut.
8. Shoqëria mund të hyjë në marrëveshje partneriteti për plotësimin e objektivave të saj vetë apo në bashkëpunim me aktorë publikë dhe/ose privatë shqiptarë ose të huaj. Ajo gjithashtu mund të lidhë marrëveshjeve bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm publik dhe/ose privat, për vënien në shfrytëzim dhe efikasitet të pasurive të paluajtshme duke realizuar çdo aktivitet të mundshëm brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni dhe statuti.
9. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sipas këtij statuti.



## Neni 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të papërcaktuar.

## Neni 6 Kapitali themeltar dhe kuotat

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë të vetme me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili ka shlyer kontributin në shoqëri, në para në shumën e barabartë me 100.000 (njëqind mijë) lekë.
3. Bazuar në kontributet e cituara më sipër:  
Fondi Shqiptar i Zhvillimit zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 100% (një qind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

## Neni 7 Transferimi i Kuotave

Kuotat e shoqërisë mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 7 të Statutit të Shoqërisë.

## Neni 8 Organizimi dhe funksionimi

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, do të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkangjitet këtij Akti Themelimi dhe përbën pjesë integrale të tij.

## Neni 9 Administratori/ët

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 10 Dispozita të Fundit

1. Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në shqip.
2. Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

**THEMELUES**

**ORTAKU I VETËM**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv

**DRTAN AGOLLI**



**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve” sh.p.k.**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, person juridik shqiptar, me nr. NIPT:J62325010W, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe adresë Rr."Sami Frasheri", Nr.10, Tiranë, Shqipëri - në cilësinë e themeluesit dhe ortakut të vetëm, në bazë të ligjit Nr.10130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit” të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.191, datë 30.12.2019 “Për miratimin e krijimit dhe objektit të veprimtarisë së shoqërisë tregtare themeluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për menaxhimin dhe vënien në efikasitet të aseteve publike të degraduara apo me potencial të pazhvilluar”, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar si dhe të akteve të tjera të legjislacionit shqiptar në tërësi, harton dhe miraton Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Agjencia e Menaxhimit të Investimeve” sipas tekstit të mëposhtëm:

**MISIONI**

Misioni i Agjencisë së Menaxhimit të Investimeve do të jetë nxitja e zhvillimit ekonomik rajonal nëpërmjet menaxhimit dhe vënies në efikasitet të aseteve publike të degraduara apo me potencial të pazhvilluar, si dhe krijimit të modeleve të menaxhimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme.

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Forma dhe Emri i Shoqërisë**

1. Ortaku i mësipërm organizon shoqërinë sipas formës ligjore me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti.
2. Emri i shoqërisë do të jetë: " **Agjencia e Menaxhimit të Investimeve** " - AML sh.p.k (që më poshtë do të quhet “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të ketë për objekt veprimtarie, por pa u kufizuar:

1. Vënia në efikasitet e pasurive publike të degraduara apo me potencial të pazhvilluar në funksion të zhvillimit rajonal duke angazhuar kapitalin e FSHZH-së, kapitalin publik dhe/ose kapitalin privat.
2. Kryerjen e investimeve dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike duke angazhuar kapital publik dhe/ose privat vendas dhe/ose të huaj.



3. Projektimin, ndërtimin, rikonstruksion, restaurim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me tipologjitë e ndryshme të ndërtesave me karakter social, kulturor, tregtar, publik etj.
4. Ofrimin e shërbimeve, mallrave, punimeve dhe aktiviteve të tjera në funksion të projektimit, ndërtimit, zhvillimit, rregjistrimit të pasurive, vënies në shfrytëzim të pasurive të paluajtshme, administrimit, mirëmbajtjes, energjisë së rinovueshme, zhvillimit të komunitetit etj.
5. Të operojë si shoqëri administruese për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa, ambiente të përbashkëta si zona gjelbërimi, fusha sportive, parking etj në marrëveshje me pushtetin vendor dhe/ose aktorë të tjerë.
6. Kërkime, analizë, studime, planifikime, projekte, konsulencë dhe cdo lloj shërbimi tjetër në fushën e pasurive të paluajtshme duke përfshirë sektorin publik dhe privat; identifikimin e objekteve apo zonave me potencial zhvillimi ekonomik në nivel rajonal apo kombëtar; aplikimin e trendeve të teknologjisë në funksion të zhvillimit, menaxhimit dhe administrimit të aseteve.
7. Shoqëria mund të realizojë çdo lloj aktiviteti, operacion financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi; financimin ose bashkëfinancimin e projekteve nëpërmjet instrumentave ekonomikë për realizimin e objektivave të përcaktuara në statut.
8. Shoqëria mund të hyjë në marrëveshje partneriteti për plotësimin e objektivave të saj vetë apo në bashkëpunim me aktorë publikë dhe/ose privatë shqiptarë ose të huaj. Ajo gjithashtu mund të lidhë marrëveshjeve bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm publik dhe/ose privat, për vënien në shfrytëzim dhe efikasitet të pasurive të paluajtshme duke realizuar çdo aktivitet të mundshëm brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni dhe statuti.
9. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e aktiviteve sipas këtij statuti.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

### **Neni 4 Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr."Muhamet Gjolleša", Nd 70/1, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë që me vendim të Asamblese së Ortakëve të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytet të tjera të Shqipërisë.

### **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë i ndarë në një kuotë të vetme.

Ortaku themelues - Fondi Shqiptar i Zhvillimit është zotëruar i kuotës të vetme me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Asambleja mund të zmadhojë apo të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë në zbatim të këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Kontributet e reja për zmadhimin e kapitalit mund të konsistojnë në para ose kontribute në natyrë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. shitblerjes;
- c. trashëgimisë;
- d. dhurimit;
- e. çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Drejtimi i Shoqërisë, Marrja e Vendimeve, Administrimi dhe Kontrolli i Shoqërisë

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë, do të jetë Asambleja e Përgjithëshme. Asambleja Përgjithëshme, mbledhet si rregull 2 herë në vit si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesën e kapitalit themeltar që ai zotëron.



Asambleja e Përgjithëshme organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortakët përballojnë humbjen e shoqërisë, deri në kufirin e vlerës së kontributit të secilit.

## Neni 9

### Asambleja e Përgjithëshme dhe kompetencat e saj

1. Asambleja e Përgjithëshme e ortakëve (që më poshtë do të quhet Asambleja) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. miratimin e statutit dhe të ndryshimeve të tij;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e lirimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" dhe "d" të kësaj pike.
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
  - i. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - j. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - n. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
3. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithëshme.

## Neni 10

### Përbërja e Asamblesë së Përgjithëshme

Asambleja e Përgjithëshme e kësaj shoqërie përbëhet nga ortaku i vetëm i saj Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

## Neni 11

### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme dhe marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithëshme thirret nga Administratorët apo Ortakët e shoqërisë.
2. Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'i dërgohet ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.



3. Vendimet janë të vlefshme me votën e Ortakut të vetëm të shoqërise, meqënëse ai zotëron 100 për qind të kuotave.
4. Përveç rasteve kur parashikohet në statut, Asambleja mbledhet kur në rastet kur:
  - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

## Neni 12 Administrimi

1. Administratori i Shoqërisë emërohet Z. Valdrin Pjetri , i biri i Luigj dhe Drane, i datëlindjes 18.09.1982, lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I20918140C si Administrator i Agjencisë së Menaxhimit të Investimeve . Kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet.
1. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 13 Kompetencat e Administratorit/ëve

1. Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Në rastet e parashikuara në pikën 3 e 5 të nenit 82 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme

3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 14 Përgjegjësitë e Administratorit

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:
  - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d. të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
3. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
4. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
5. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
  - a. u kthen ortakëve kontributet;
  - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - e. jep kredi.

#### Kreu IV Viti financiar- Aktiviteti financiar



## Neni 15 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## Neni 16 Aktiviteti financiar

1. Shoqëria mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet në mënyrë të hollësishme gjendja e saj financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Administratori përgatit raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde kontabiliteti, sipas ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.
4. Dokumentat vihen në dispozicion të ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën një muaj para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 17 Ndarja e fitimeve

1. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore të miratuara nga Asambleja shpërndahen, si me poshtë vijon:
  - a. 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit;
  - b. Me vendim të Asamblesë pjesa e mbetur e fitimit mund të riinvestohet, të shërbejë si rritje kapitali apo të shpërndahet si dividendë, në përputhje me ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
2. Në rast se Asambleja vendos për ndarjen e fitimit, shpërndarja bëhet në përqindje me kuotat e zotëruara.

## Kreu V Prishja - riorganizimi i shoqërisë

### Neni 18 Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria mund të priset si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
2. Në rast prishje, Shoqëria kalon në procedurë likuidimi, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
3. Në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin

përfundimtar për aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë dhe për procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin.

4. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja vendos për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
5. Pasurite e administruara me kusht që kërkojnë kthim ose transferim të tyre nëmomentin e shpërbërjes së Shoqërisë, kthehen ose transferohen sipas kushtit në fjalë.
6. Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe fondet fillestare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna

#### Neni 19

#### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, shndërrrohet sipas Vendimit të Asamblesë, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

#### Neni 20

#### Dispozita të fundit

Shoqëria ka të drejtë të punesojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vëna në kontratën e veçantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit e punonjësit.

#### Neni 21

#### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETËM

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv

DRITAN AGOLLI

